PROGRAMI IPA I BASHKIMIT EVROPIAN PËR KOSOVË

# Ndihmë teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë

Kontrata nr.: 2019/413-800

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

Janar 2021

giz International Services

## Klauzola për mos marrjen e përgjegjësisë

Ky Raport është përgatitur nga ekipi i projektit. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë ato vetëm të Kontraktuesit dhe në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si të tilla që pasqyrojnë politikat ose mendimet e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë.

## Përmbledhje Ekzekutive

Prokurimi publik i centralizuar, ku një Organ Qendror Blerës që përfaqëson nevojat kolektive të ministrive dhe organeve të tjera shtetërore, është përgjegjës për aktivitetet e prokurimit për kategoritë e zgjedhura të furnizimeve dhe shërbimeve.

Arsyetimi për një qasje të centralizuar është se ka të ngjarë të jetë më efikase ekonomikisht përmes blerjes me shumicë dhe ekonomive të shkallës.

Argumentet kryesore për prokurimin e centralizuar përfshijnë:

- Aftësia për të përdorur ulje të konsiderueshme të çmimeve.
- Marrja e shërbimeve më të mira me kosto më të ulët.
- Standardizimi teknik i produkteve dhe shërbimeve.
- Përmirësimi i menaxhimit të kontratës dhe zgjidhjes së problemeve.
- Kosto më të ulëta të trajnimit.
- Menaxhimi më i lehtë i performancës së stafit të prokurimit.
- Transparenca, raportimi, menaxhimi dhe auditimi i përmirësuar; dhe
- Kursimet nga kostoja e punës.

Agjencia Qendrore e Prokurimit e Kosovës (AQP), u themeluar sipas ligjit në vitin 2011 me një mandat për të bërë prokurime të centralizuara në emër të Autoriteteve Kontraktuese (AK) në Kosovë. Pavarësisht nga kompetencat ligjore që i janë dhënë AQP-së, ajo nuk u bë funksionale deri në vitin 2015 kur, për herë të parë, lista e prokurimeve të centralizuara u miratua nga Qeveria.

Kjo analizë shqyrtoi 3 (tre) aktivitete qendrore të prokurimit të AQP-së gjatë dy viteve të fundit për të parë:

- A është ende i rëndësishëm përdorimi i prokurimit të kufizuar të centralizuar përmes ofrimit të vlerës për para?
- A ofron AQP-ja vlerën për para?
- Sa janë efikase aktivitetet e përzgjedhjes dhe kërkimit të tregut për artikujt që rekomandohen për prokurimin qendror?

Nga 3 (tre) aktivitetet e prokurimit, 10 (dhjetë) artikujt më të përdorur u zgjodhën për Analizën e Kostos-Përfitimit (CBA).

Për ta mundësuar analizën CBA, u përdorën dy metodologji të ndryshme:

- **Analiza e opsionit 1: Krahasimi i çmimeve të kontratës së AQP-së me çmimet e mëparshme të Organizatave Buxhetore (OB)**
    a. Metodologjia e përdorur për 8 artikuj të përzgjedhur (mish, vaj ushqimor, ujë, qumësht, bukë, letër A4, letër A3 dhe regjistratorë) është që u morën 3 (tre) çmime për të njëjtin artikull nga çmimet e mëparshme të 3 (tre) Organizatave Buxhetore (OB) (modeli i decentralizuar i funksionimit) të cilat shpenzuan sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. Një çmim mesatar është përzgjedhur dhe krahasuar me çmimet e AQP-së.
    b. Ndërsa metodologjia e përdorur për 2 artikujt e përzgjedhur të mbetur (naftë dhe benzinë) është se u morën 3 (tre) çmime për të njëjtin artikull nga çmimet e

mëparshme të 3 (tre) OB-ve (modeli i decentralizuar i funksionimit) të vitit 2012 të cilat shpenzuan sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar dhe u krahasuan me çmimet e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) të vitit 2012. Për shkak të faktit se çmimi i karburantit ndryshon çdo ditë dhe faktit që nga viti 2012 AQP, në emër të OB-ve, filloi të përmbyllë aktivitetet për këta 2 artikuj të përzgjedhur, fillimisht përmes një prokurimi të përbashkët (në baza vullnetare) dhe vazhdoi me prokurimet e centralizuara (të detyrueshme) për vitin 2015, është e papërshtatshme të krahasohen çmimet e mëparshme të OB-ve (2012) me çmimet e kontraktuara të AQP-ve për vitin 2015.

- **Analiza e opsionit 2: Krahasimi i çmimeve kontraktuese të AQP-së me çmimet e tregut.** Në lidhje me faktin se çmimet e mbledhura nga OB-të ishin çmime para vitit 2015, pasi që nga viti 2015 AQP-ja ka vazhduar lidhjen e këtyre kontratave në emër të OB-ve dhe nuk është e përshtatshme të krahasohen çmimet aktuale të AQP-së me çmimet e vjetra të OB-ve, ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK-ja e Kosovës/çmimet e tregut me çmimet e kontraktuara të AQP-së.
    a. Metodologjia e përdorur për 7 artikuj të zgjedhur (naftë, benzinë, mish, qumësht, ujë, bukë dhe vaj ushqimore) për të cilat ASK publikon çmime, është krahasimi i çmimeve e publikuara të ASK/ çmimet e tregut me çmimet e kontraktuara të AQP-së.
    b. Ndërsa për 3 artikujt e tjerë (letër A4, letër A3 dhe regjistratorë) pasi që nuk ka çmime zyrtare të publikuara nga ASK, metodologjia e përdorur është që 3 (tre) çmime për të njëjtin artikull nga 3 (tre) Operatorë Ekonomikë (OE) janë mbledhur direkt nga OE. Një çmim mesatar është përzgjedhur dhe krahasuar me çmimet e AQP-së.

**Analiza jonë e 10 mostrave tregon se për analizën e opsionit të parë, kursimet e mundshme janë përafërsisht 4.5 milion €, dhe për analizën e opsionit të dytë kursimet e mundshme janë përafërsisht 3.8 milion €.**

Analiza e opsionit dy është krahasimi më i rëndësishëm pasi kjo reflekton krahasimin e çmimeve të kontraktuara të AQP-ve me çmimet e tregut. 'Kursimet' e raportuara duhet të zbuten nga fakti që këto "kursime" llogariten duke shumëzuar sasinë e parashikuar në dokumentet e tenderit me çmimin mesatar kundrejt sasisë së parashikuar në dokumentet e tenderit me çmimet e ASK-së. Mirëpo, ne e dimë që shumë OB nuk japin informacione mbi sasitë dhe vlerësimet e buxhetit kur kërkohen nga AQP.[1] Në këto raste, AQP-të, për qëllimet e tyre, në mënyrë arbitrare vlerësojnë sasitë që janë ndoshta më të larta se sa do të duhej të jenë. Këto më pas shumëzohen me koston mesatare të njësisë duke dhënë një shpenzim të përgjithshëm të vlerësuar të buxhetit që është dukshëm më i lartë se kontratat për këta artikuj.

**Për shembull, në Raportin Vjetor të Punës të AQP 2019 ai ka një vlerë totale të vlerësuar të të gjitha pjesëve (loteve) prej afërsisht 75 milion € dhe një vlerë të kontraktuar rreth 55 milion €. Raporti vjetor e paraqet këtë si kursime prej përafërsisht 20 milion € ose 26%. Kjo shifër duhet të trajtohet me kujdes pasi me përjashtim të 1 kontrate, 30 vlerat e tjera të parashikuara tejkaluan vlerat aktuale të kontratës në mënyrë të konsiderueshme dhe, (në**

[1] 21% dhe 17% e AK-ve nuk i dhanë AQP-së të dhëna sipas kërkesës për Prodhimet e Karburantit dhe Furnizimin me Letër përkatësisht në vitin 2017. Burimi: Raporti i Auditimit të Performancës së ZKAK Vlera për Paratë në Prokurimet e Centralizuara Pjesa e parë - maj 2018.

**disa raste ndryshimet ishin në milion € dhe 8 nga 31 kontratat llogariten 'kursime' në shumë rreth 15.5 milion € ). Një ndryshim prej 26% midis vlerës së parashikuar dhe asaj aktuale ndoshta tregon të meta serioze në krijimin e vlerave te parashikuara.**[2]

**Aktualisht, Raportet Vjetore të Punës të AQP nuk japin ndonjë shpjegim për këto ndryshime të rëndësishme. Mirëpo, në aktivitetin e projektit 4.4 ne jemi në proces të rishikimit të përmbajtjes, skemës dhe transparencës së modelit për Raportet Vjetore të Punës të AQP. Ne parashikojmë që këshillat tona për AQP lidhur me përmbajtjen e Raportit Vjetor të Punës të përfshijnë rekomandime për të shpjeguar arsyet për këto ndryshime, duke siguruar kështu një transparencë më të madhe nëse këto 'kursime' të raportuara janë të besueshme.**

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se prokurimet e centralizuara të udhëhequra nga AQP me siguri po gjenerojnë kursime në aspektin ekonomik, megjithatë për sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të VPP ka hapësirë për përmirësim.[3] Fusha kryesore që duhet të përmirësohet është **hulumtimi i hollësishëm i tregut** për të përcaktuar thellësinë dhe konkurrencën e furnizuesve të mundshëm kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës (ZKAK) aktualisht është duke përfunduar pjesën e dytë të raportit të saj të Auditimit të Performancës për AQP. Sipas pjesës së parë të raportit të ZKAK ***'Analiza joadekuate e kontratës (individuale) nga Autoritetet Kontraktuese dhe mungesa e ndonjë forme të hulumtimit të tregut rezultoi në kontraktimin e çmimeve më të larta sesa ato të disponueshme në treg.'***

**Prandaj, përgjigjet e pyetjeve të parashtruara nga kjo analizë janë:**

- **Përdorimi i prokurimeve të centralizuara është ende i rëndësishëm.**
- **Agjencia Qendrore e Prokurimit ndoshta po siguron vlerë për para, megjithatë, kjo mund të përmirësohet duke bërë hulumtime të thella të tregut dhe duke përcaktuar çmime referuese.**

Së fundmi, ne kemi përfshirë rekomandime të cilat duhet të merren parasysh nga AQP për të rritur efektivitetin e tij teknik dhe operacional.

---

[2] Burimi: Raporti Vjetor i Punës i vitit 2019 mbi AQP-ne shkurt 2020 Grafiku Nr.1 Aktivitetet e Drejtorise se Prokurimit te Centralizuar.
[3] Vlera për Para (VPP) ka tre elemente thelbësorë: Ekonominë, Efikasitetin dhe Efektivitetin.

## Tabela e përmbajtjes

Lista e akronimeve dhe shkurtesave ..... 7
1. Hyrje ..... 8
2. Historiku dhe konteksti ..... 9
2.1 Planifikimi dhe analiza e tregut e AQP-së ..... 10
2.2 Llogaritja e vlerave të kontratës ..... 12
3. Metodologjia e përdorur për analizën ..... 13
4. Analiza dhe mbledhja e çmimeve për njësi ..... 14
4.1 Produkte të naftës (Naftë 10 ppm dhe Benzinë 10 ppm) ..... 14
4.2 Furnizimi me artikuj ushqimorë ..... 16
*4.2.1 Furnizimi me mish dhe produkte mishi* ..... 16
*4.2.2 Furnizim me produkte qumështi* ..... 17
*4.2.3 Furnizimi me ujë, pije të gazuara dhe të pa gazuara* ..... 17
*4.2.4 Furnizimi me artikuj ushqimorë* ..... 18
*4.2.5 Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera* ..... 19
4.3 Furnizimi me letër dhe artikuj për zyrë ..... 20
*4.3.1 Furnizimi me letër A4/80 g/m2* ..... 20
*4.3.2 Furnizimi me letër A3/80 g/m2* ..... 21
*4.3.3 Furnizimi me regjistratorë, me ngjyra, me kuti 80 mm gjerësi të përshtatshme për letër A4 me madhësi 475- 75i* ..... 22
4.4 Kursime të tjera të mundshme ..... 23
5. Përmbledhje e analizës ..... 23
6. Konstatimet & Rekomandimet ..... 24
Referenca ..... 27
Aneksi 1: Informacione dhe të dhëna të detajuara që mbështesin përmbajtjen e raportit 29
Aneksi 2: Pasqyrë e kontratave të nënshkruara të AQP-së 2019-2020 (*shih tabelën e bashkëngjitur të Excel*) ..... 63

## Lista e akronimeve dhe shkurtesave

| | |
|---|---|
| AK | Autoriteti Kontraktues |
| APP | Agjencia e Prokurimit Publik |
| AQP | Agjencia Qendrore e Prokurimit |
| ASK | Agjencia e Statistikave të Kosovës |
| BB | Banka Botërore |
| CBA | Analiza e kostos dhe përfitimit |
| EO | Operatori Ekonomik |
| KRPP | Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik |
| LPP | Ligji për Prokurimin Publik |
| MF | Ministria e Financave |
| OB | Organizatat Buxhetore |
| TeR | Termat e referencës |
| UA | Udhëzim Administrativ |
| VPP | Vlera për para |
| ZBEK | Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë |
| ZKA | Zyrtari Kryesor Administrativ |
| ZKAK | Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë |

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

## 1. Hyrje

Në Kosovë, pothuajse 11% e BVP-së shpenzohet në prokurimin publik dhe, për këtë arsye, është e rëndësishme që paratë e tatimpaguesve të shpenzohen në mënyrën më efektive dhe të dobishme.[4]

Në vitin 2004, për të përmirësuar fleksibilitetin për Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE), Direktiva 2004/18/EC mbi koordinimin e procedurave të prokurimit për sektorin publik, inkorporoi **dispozitën e marrëveshjeve kornizë**. Kjo dispozitë iu lejoi Shteteve Anëtare të krijojnë rregullat e tyre kombëtare për t'i bërë prokurimet më të thjeshta, më fleksibile dhe më të menaxhueshme. Marrëveshja kornizë lejon autoritetet kontraktuese të bëjnë blerje të rregullta të mallrave, shërbimeve dhe/ose punëve për të cilat autoriteti kontraktues ka një nevojë të përsëritur. Me fjalë të tjera, këto janë produkte ose shërbime të standardizuara, të tilla si materiali zyrtar, karburanti, artikuj ushqimorë, etj.

Nevoja për një institucion të centralizuar të prokurimit në Kosovë është njohur për shumë vite. Në një vlerësim të vitit 2008 nga Banka Botërore (BB), u rekomandua që Agjencia e Prokurimit Publik (APP)[5] (ish-Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)) to fillonte me përdorimin e një mekanizmi të përqendruar të blerjes pasi që kjo mund të kursejë shuma të konsiderueshme të mjeteve publike.

Në mbështetje të rekomandimit të saj, BB analizoi një shembull të shtatë kategorive të produkteve (dhe vlerësoi se zbatimi i një qasjeje të centralizuar të kontratës kornizë me gjasë do të mund të realizonte kursime vjetore në kufirin prej 12.3 dhe 18.3 milion €. Analiza e BB më tej raportoi se ndryshimet në kostot për njësi për blerjet e bëra nga Organizatat Buxhetore (OB) mund të jenë aq të larta sa një variancë prej 95%.

Sidoqoftë, përkundër provave bindëse për të zbatuar një prokurim të kufizuar të centralizuar, vetëm në vitin 2011 LPP i Ri, Nr.04/L-042[6], Neni 94, inkorporoi **Agjencinë Qendrore të Prokurimit "AQP" si Organ Qendror të Blerjes**. AQP është përgjegjëse për menaxhimin e aktiviteteve të prokurimit të centralizuar përmes përdorimit të marrëveshjeve kornizë në emër të administratës qeveritare, pas miratimit nga ana e qeverisë.[7] Përkundër këtij mandati primar ligjor, AQP-ja nuk filloi asnjë aktivitet deri në vitin 2015, kur udhëzimi i parë administrativ (UA) u miratua nga Qeveria. Arsyet për vonesën në funksionalizimin e AQP-së vijnë kryesisht nga mungesa e vullnetit politik për ta realizuar këtë. Mirëpo, në periudhën e ndërmjetme midis viteve 2011 dhe 2015, AQP-ja ofroi ndihmë dhe këshilla të përgjithshme të prokurimit ad-hoc për OB-të.

Prandaj, kemi një hendek prej 8 viteve (2008-2015) midis BB-së që rekomandon prokurimin specifik të centralizuar dhe funksionalizimit të AQP-së. Është e qartë se ky hendek pothuajse me siguri do të rezultojë në humbjen e dhjetëra miliona eurove nga çanta publike për shkak të pagimit më shumë për mallra dhe shërbime duke përdorur blerje të decentralizuara dhe të rastësishme të artikujve zakonisht përdorimit te përbashkët.

[4] Raporti Vjetor i KRPP-së 2019: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Reports/2019/alb/Raporti%20vjetor%202019_KRPP_PDF.pdf
[5] Duke qenë pararendës i AQP.
[6] https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/ligjet/english/Ligji%20per%20prokurimin%20publik%20%28anglisht%29-1.pdf
[7] Neni 95 i Ligjit.

Projekti i financuar nga BE "**Ndihma teknike për mbështetjen e zbatimit të Reformave për Menaxhimin e Financave Publike në Kosovë**", filloi në janar 2020.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është "***të kontribuojë në një menaxhim të shëndoshë financiar dhe përmirësim të ofrimit të shërbimeve në Kosovë duke përmirësuar disiplinën fiskale, duke rritur mobilizimin e të ardhurave dhe shpërndarjen strategjike të burimeve përmes ofrimit të këshillave për politika dhe mbështetje për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe të burimeve njerëzore në Ministrinë e Financave dhe institucionet përkatëse".***

Një aktivitet i identifikuar i projektit ishte të bëhej një Analizë e kostos dhe përfitimit (CBA) të aktiviteteve të prokurimit të centralizuar në dy vitet 2019 dhe 2020.

Termat e Referencës specifike dhe të detajuara (ToR) janë përgatitur nga projekti dhe aprovuar nga Zyra e BE në Kosovë (ZBEK). Një ekspert me përvojë të përshtatshme u identifikua, aprovua, kontraktua dhe u caktua në nëntor 2020 me punën fillestare në terren për këtë aktivitet që u përfundua në fund të dhjetorit të vitit të njëjtë.

Përgjigjet ndaj pyetjeve thelbësore vijuese të përcaktuara në ToR ofrojnë bazën për këtë analizë:

- ***Relevanca** – A është ende i rëndësishëm përdorimi i prokurimit të kufizuar të centralizuar përmes ofrimit të vlerës për para?*
- ***Efektiviteti** – A ofron AQP-ja vlerën për para?*
- ***Efikasiteti** – Sa janë efikase aktivitetet e përzgjedhjes dhe hulumtimit të tregut për artikujt që rekomandohen për prokurimin qendror?*

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se prokurimet e centralizuara të bëra nga AQP me siguri po gjenerojnë kursime në aspektin ekonomik, megjithatë për sa i përket efikasitetit dhe efektivitetit të VPP ka hapësirë për përmirësim.[8] Fusha kryesore që duhet të përmirësohet është **hulumtimi i hollësishëm i tregut** për të përcaktuar thellësinë dhe konkurrencën e furnizuesve të mundshëm kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Mungesa e aktiviteteve kuptimplota të hulumtimit të tregut nga AQP-ja është cituar nga një numër burimesh përfshirë Dokumentin e Punës të Stafit të Komisionit Evropian Raporti për Kosovën 2020: ***'Kapaciteti i kufizuar i Agjencisë për të kryer hulumtime të duhura të tregut do të thotë se nuk siguron ekonomi të shkallës që pritet nga prokurimi i centralizuar.'***

## 2. Historiku dhe konteksti

Pothuajse që të gjitha vendet evropiane kanë disa rregullime të centralizuara të prokurimit. Këto ndryshojnë për sa i përket kornizave organizative dhe ligjore; megjithatë, të gjithë ndajnë ambicien për të përmirësuar VPP-në në prokurimin publik.[9] Prokurimet qendrore janë më efektive në kursimin e kostove kur blihen artikuj të përgjithshëm dhe të përdorur gjerësisht me shumicë sesa pjesë-pjesë (me pakicë). Shumica e vendeve evropiane ndajnë burime të konsiderueshme për

[8] Vlera për Para (VPP) ka tre elemente thelbësorë: Ekonominë, Efikasitetin dhe Efektivitetin.
[9] OECD (2011), "Sistemet e Blerjes së Centralizuar në Bashkimin Evropian", *Dokumentet SIGMA*, Nr 47, Publikimet e OECD, Paris, https://doi.org/10.1787/5kgkgqv703xw-en.

**planifikim dhe analizë të tregut** para marrjes së vendimeve për procedurat qendrore ose kontratat kornizë.

Ligji i LPP-së Nr. 04/L-042[10], Neni 95, i përcakton AQP-së autorizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë për të:

i. Kryerja dhe realizimi i prokurimeve të centralizuara, për të gjitha AK-të në Kosovë, nëse autorizohet nga Qeveria.
ii. Përgatitja dhe dërgimi në Ministrinë e Financave i një liste të artikujve ose mallrave, punëve ose shërbimeve për përdorim të përbashkët, të cilat do të shpërblehen nga AQP-ja. Kjo listë e propozuar nga Ministria e Financave miratohet nga Qeveria në formën e një Udhëzimi Administrativ, me 31 janar të çdo viti.
iii. Kryerja dhe realizimi i prokurimeve në emër të AK-ve, me kërkesë të AK-së dhe sipas arsyetimit adekuat nga AK-ja përkatëse. Ministri i Financave, pasi shqyrton arsyetimin e AK mund t'i lejojë AQP-së, kryerjen e një aktiviteti të tillë të prokurimit.
iv. Mbështetja e AK-ve në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit, me kërkesë të AK-së.

Përkundër faktit se këto kompetenca i ishin dhënë AQP-së në vitin 2011, qeveria miratoi vetëm listën fillestare të 11 artikujve për përdorim të zakonshëm për blerje qendrore të detyrueshme në vitin 2015 përmes Udhëzimit Administrativ - Nr. 02/2015 për Zbatimin e Procedurave të Prokurimit Qendror Publik[11]

Në vitin 2016, 3 kategori të tjera u shtuan në listë si dhe edhe 4 të tjera në vitin 2017. Që nga viti 2018, lista e kategorive ka mbetur e pandryshuar në 18. Detajet e këtyre kategorive janë në Aneksin 1 të këtij raporti.

Neni 95.3 i LPP përcakton që "*Autoriteti kontraktues nuk do të kryejë një aktivitet të pavarur të prokurimit në lidhje me këto mallra, punë ose shërbime. Çdo kontratë e lidhur në kundërshtim me këtë paragraf do të shpallet e pavlefshme*", dhe prandaj AK-të janë të obliguara të përdorin kontratat e lidhura nga AQP-ja.

## 2.1 Planifikimi dhe analiza e tregut e AQP-së

Neni 8 paragrafi 2 i LPP-së kërkon që "*brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit për ndarjet buxhetore për një vit fiskal, secili autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik ose një ndërmarrje publike, t'i ofrojë AQP-së, me shkrim, një parashikim përfundimtar të prokurimit që identifikon në detaje të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon të blejë gjatë këtij viti fiskal*".

Në vitin 2015, Ministria e Financave (MF) caktoi një grup punues për të hartuar Udhëzimin Administrativ për aktivitetet e prokurimit të centralizuar. Ky grup punues përbëhej vetëm nga personeli i AQP-së. Për të përcaktuar kategoritë fillestare për prokurimin e centralizuar, grupi punues rishikoi planet e prokurimit të AK-ve dhe AQP-ja identifikoi 11 kategori të përgjithshme të përfshira në planet e prokurimit të AK-ve. Këto kategori të përgjithshme i pasuan rekomandimeve nga vlerësimi i BB-së që u bë në vitin 2008 ku BB rekomandoi që Agjencia e Prokurimit Publik

[10] https://krpp.rks-gov.net/krpp/PageFiles/File/ligjet/shqip/Ligji%20per%20Prokurim%20Publik%20Nr%2004%20L%20%20042.pdf
[11] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10772

(APP)[12] (ish-Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP)) të fillonte me përdorimin e një mekanizmi të përqendruar të blerjes pasi që kjo me gjasë do të mund të kursente shuma të konsiderueshme të mjeteve publike.

Pas konsultimit publik, ky propozim u miratua nga Qeveria përmes UA Nr. 02/2015.[13] Sidoqoftë, AQP-ja nuk bëri hulumtime ose analiza më të gjera të tregut për të përcaktuar përfitimet e mundshme të kostos së këtyre **11 kategorive**.

AQP-ja hartoi një model standard, për secilën kategori në mënyrë që të mblidhte të dhënat e mëposhtme nga AK-të:

- Kur është nënshkruar kontrata e OB-ve dhe kur do të skadonte;
- Sasia e parashikuar e OB-ve - sasia e porositur vitin e kaluar;
- Numri i tenderëve të pranuar, numri i tenderëve të përgjegjshëm të pranuar; dhe
- Sa herë i njëjti aktivitet u rishpall (ri-tenderim).

Para miratimit të UA Nr. 02/2015, AQP bazuar në nenin 95, Paragrafi 4, të LPP-së, bëri një aktivitet të përbashkët të prokurimit për 37 AK lidhur me **"Furnizim me produkte të karburantit"**[14] Kjo kategori më pas u bë pjesë përbërëse në të gjitha listat pasuese të prokurimeve të centralizuara.

Prandaj, në vitin 2015[15] ne kishim 11 kategori të aprovuara për prokurimin e centralizuar.

| Nr. | 2015 |
|---|---|
| 1 | Furnizimi me karburant |
| 2 | Furnizimi me material zyrtar |
| 3 | Shërbime transporti (furnizim me bileta) |
| 4 | Furnizimi me vaj të rëndë (mazut) |
| 5 | Furnizimi me pelet |
| 6 | Furnizimi me goma |
| 7 | Furnizimi me dru dhe qymyr (2 lote) |
| 8 | Furnizimi me material higjienik (2 lote) |
| 9 | Furnizimi me artikuj ushqimorë (5 lote) |
| 10 | Shërbime pastrimi (11 lote) |
| 11 | Furnizimi me pemë dhe perime (FA me disa OE) |

[12] Duke qenë paraardës i AQP.
[13] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10772
[14] Ky studim i përbashkët u bë në përgjigje të një rekomandimi të ZKAK te vitit 2011 që nxiti Qeverinë të centralizojë prokurimin e produktove të naftës.
[15] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10772

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

3 kategoritë e mëposhtme u shtuan në listë në vitin 2016[16]:

- **Marrja me qira e makinave të fotokopjimit** - kjo u bazua në hulumtimin e AQP-së lidhur me praktikat më të mira në vendet e tjera evropiane.
- **Furnizimi me pajisje e TI** - kjo ishte bazuar në nevojën për të standardizuar specifikimet teknike të këtyre artikujve.
- **Furnizimi me lubrifikantë** - kjo kategori nuk u iniciua asnjëherë pasi OB-të u ankuan për kategorinë duke deklaruar se ata kishin kontrata aktive për "Shërbimet e mirëmbajtjes së automjeteve" dhe lubrifikantët janë pjesë e atyre kontratave.

Në vitin 2017[17], 4 kategori të tjera u shtuan:

- **Automjetet me qira** - kjo u rekomandua për herë të parë nga ZKAK në vitin 2015. Sidoqoftë, ky rekomandim u zbatua vetëm pasi ishte krijuar një grup për analizim dhe raportim te AQP-ja lidhur me këtë rekomandim të ZKAK. Grupi rekomandoi që automjetet me qira të përfshiheshin në listë.
- **Furnizimi me mobilie** - kjo ishte bazuar në nevojën për të standardizuar specifikimet teknike të këtyre artikujve.
- **Furnizimi me automjete**- kjo ishte bazuar në nevojën për të standardizuar specifikimet teknike të këtyre artikujve.
- **Shërbime të printimit** - kjo ishte bazuar në hulumtimin e AQP-së lidhur me praktikat më të mira.

Që nga viti 2017 kemi 18 kategori të aprovuara për prokurim të centralizuar dhe asnjë ndryshim nuk është bërë në listë nga ajo datë.[18]

Kuptimi nga AQP-ja i hulumtimit dhe analizës së tregut duket se është i kufizuar në konsultimin dhe kërkimin e informacionit nga AK-të. Pavarësisht rekomandimeve nga KE,[19] BB dhe të tjerët, AQP-ja nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë kuptimplote për të zgjeruar fushën e kërkimit dhe analizës së tregut për të përfshirë operatorët ekonomikë kombëtarë, rajonalë dhe ndërkombëtarë.

## 2.2 Llogaritja e vlerave të kontratës

Neni 8 i LPP përcakton që "*Para se një autoritet kontraktues të fillojë ndonjë aktivitet të prokurimit, Zyrtari Kryesor Administrativ i autoritetit kontraktues (ZKA) do të sigurojë që të bëhet një vlerësim zyrtar i nevojave. Ky vlerësim do të përcaktojë (ii)* ***vlerën e parashikuar*** *dhe llojin e propozuar dhe kushtet materiale të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të parashikuar.* "

Në periudhën 2019-2020, AQP-ja nënshkroi 51 kontrata. Dallimi midis **vlerave të parashikuara të këtyre kontratave ishte 103 milion € ndërsa vlera reale e kontraktuar ishte 92 milion €, një diferencë prej 11 milion €.**

[16] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15093
[17] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15130
[18] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15130
[19] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/kosovo_report_2020.pdf

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

AQP-së iu kërkua të shpjegonte bazën se si arriti në vlerën e llogaritur të kontratave dhe ata u përgjigjën se vlera e llogaritur bazohet në:

- Çmimet e tregut;
- Çmimet kontraktuese të kontratave të mëparshme; dhe
- Vlerat e parashikuara të AK-ve.

Kjo bazë për llogaritjen e vlerës së llogaritur injoron nevojën për analiza më të thella të propozimeve të AK-ve, që do të shqyrtonin situatën më të gjerë të tregut, kushtet e konkurrencës, shumëllojshmërinë e ofertave dhe dinamikën kohore. Në këtë mënyrë, do të ishte më lehtë të arsyetohet një listë e kategorive të rekomanduara për prokurimin qendror.

**Rezultati i metodologjisë aktuale të përdorur nga AQP-ja për llogaritjen e vlerave të kontratës është se këto janë gjithmonë më të larta se vlerat reale të kontratës dhe ndryshimi raportohet nga AQP-ja si 'kursime' të arritura nga veprimet e AQP-së.**

## 3. Metodologjia e përdorur për analizën

Për të përcaktuar nëse prokurimet e centralizuara ofrojnë VPP, ne kemi analizuar artikujt e prokuruar në mënyrë qendrore gjatë dy viteve të fundit, përkatësisht 2019 dhe 2020. Në këtë kontekst, VPP-ja u përcaktua si një krahasim me proceset konkurruese "normale" të tenderit. Për ta arritur këtë, u hartua një listë e kontratave të nënshkruara nga AQP-ja gjatë vitit 2019 dhe 2020 (shih Shtojcën 2).

AQP-ja dëshiron të inkurajojë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, dhe, për ta arritur këtë, dhe në përputhje me nenin 27/A të LPP-së, çdo aktivitet u nda në Lote.

Në periudhën 2019-2020, AQP-ja nënshkroi **51 kontrata** me një vlerë të llogaritur prej **103 milion €, i cili mbulonte 10 kategori** si në vijim:

1. Furnizimi me material zyrtar - 9 kontrata
2. Furnizimi me karburante - 10 kontrata
3. Furnizimi me mobilie - 2 kontrata
4. Furnizimi me artikuj ushqimorë - 10 kontrata
5. Furnizimi me goma - 2 kontrata
6. Furnizimi me makina të fotokopjimit dhe printerë - Shërbime fotokopjimi - 6 kontrata
7. Furnizimi me letër - 6 kontrata
8. Furnizimi me automjete - 4 kontrata
9. Furnizimi me pemë dhe perime - 1 kontratë
10. Furnizimi me pajisje të Ti-së - 1 kontratë

Për analizën tonë, ne fillimisht kemi zgjedhur një mostër të **4 kategorive me numrin më të lartë të kontratave:**

1. Furnizimi me material zyrtar - 9 kontrata
2. Furnizimi me karburante - 10 kontrata
3. Furnizimi me artikuj ushqimorë - 10 kontrata
4. Furnizimi me letër - 6 kontrata

Mostra u përpunua më tej duke zgjedhur 10 kontrata me shpenzimet më të larta në 4 kategori:

| Nr. | Kategoria | Artikulli i zgjedhur |
|---|---|---|
| 1 | Karburant | 1. Benzinë 10 ppm |
| | | 2. Naftë 10 ppm |
| 2 | Ushqim | 3. Mish viçi (viçi i freskët (KOFSHË), 7% yndyrë e lejuar - pa kocka) |
| | | 4. Bukë e bardhë (500g) |
| | | 5. Ujë natyral (0.50l, ambalazh plastik) |
| | | 6. Vaj (vaj ushqimor, përbërja: luledielli, i rafinuar, pa kolesterol) |
| | | 7. Qumësht (paketimi Tetra Pack, yndyrë 3.2%) |
| 3 | Letër | 8. Letër A4/80 g/m2 |
| | | 9. Letër A3/80 g/m2 |
| 4 | Artikuj për zyrë | 10. Regjistratorë, me ngjyra, me kuti. Gjerësia 80 mm e përshtatshme për madhësinë e letrës A4 475- 75l |

Për ta lehtësuar analizën në seksionin tjetër, u përdorën dy metodologji/opsione:

- **Analiza e opsioneve 1: Krahasimi i çmimeve kontraktuese të AQP-së me çmimet e mëparshme të Organizatave Buxhetore (OB); dhe**
- **Analiza e opsioneve 2: Krahasimi i çmimeve kontraktuese të AQP-së me çmimet e tregut.**

## 4. Analiza dhe mbledhja e çmimeve për njësi

### 4.1 Produkte të naftës (Naftë 10 ppm dhe Benzinë 10 ppm)

Kontrata e zgjedhur për analizë është **furnizimi me karburant - Niveli qendror**. Kjo kontratë është e ndarë në 5 Lote, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 12.07.2019 dhe skadon më 11.07.2022 (shih kontratat Nr. 8-12 në Aneksin 2).

Kjo kontratë përdoret nga 87 AK ku planifikohet të blihen gjithsej **29,169,800 litra naftë dhe 1,018,700 litra benzinë.**

**Siç diskutohet në seksionin e Metodologjisë, përdoren 2 analiza opsionesh për krahasim** (shih Aneksin 1 për analiza të hollësishme).

Analiza e opsioneve 1: Janë marrë (3) çmime nga OB-të të cilat kishin blerë sasinë më të madhe sipas kontratës së centralizuar . OB-të të cilat blenë sasinë më të madhe u identifikuan nga Dokumentet e Tenderit.

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

3 OB-të të cilat blenë sasinë më të madhe sipas kontratës për **Naftë** janë:

1. Policia e Kosovës - naftë
2. Ministria e Drejtësisë - naftë
3. Ministria e Forcës së Sigurisë - naftë

3 OB-të të cilat blenë sasinë më të madhe sipas kontratës për **Benzinë** janë:

1. Ministria e Infrastrukturës - benzinë
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - benzinë
3. Ministria e Shëndetësisë - benzinë

Për krahasim, çmimi mesatar i shpenzuesve më të mëdhenj të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimet e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) në vitin 2012.[20] Çmimet e shpenzuesve më të mëdhenj të OB-ve bazohen në një analizë të bërë nga AQP-ja në vitin 2012. Për shkak të faktit se çmimi i karburantit ndryshon çdo ditë dhe faktit që nga viti 2012 AQP, në emër të OB-ve, filloi të përmbyllë aktivitetet për këta 2 artikuj të përzgjedhur, fillimisht përmes një prokurimi të përbashkët (në baza vullnetare) dhe vazhdoi me prokurimet e centralizuara (të detyrueshme) në vitin 2015, është e papërshtatshme të krahasohen çmimet e mëparshme të OB-ve (2012) me çmimet e kontraktuara të AQP-ve për vitin 2015. Prandaj, çmimet për këta dy artikuj të zgjedhur krahasohen me çmimet e publikuara nga ASK.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 380,000 € më shumë për naftë dhe 13,000 € më pak për Benzinë sesa çmimi i AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2:** Çmimet e mbledhura nga OB ishin çmime nga viti 2012. Që nga viti 2015 AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve dhe për këtë opsion ka çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) janë krahasuar çmimet e AQP-së.

Meqenëse aktiviteti u nda në 5 Lote, dhe dy Operatorë Ekonomikë (OE) u shpërblyen me 5 Lote, AQP-ja kishte çmime të ndryshme për Lotin 1 dhe 2 nga Loti 3, 4 dhe 5.

Meqenëse kontrata tanimë ishte duke u zbatuar për 15 muaj, analiza krahasuese u bë për periudhën përkatëse **gusht 2019 - tetor 2020**. Për këtë analizë, janë përdorur mesataret e 15 çmimeve të publikuara të ASK-së dhe 15 çmimeve të publikuara të AQP-së.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, kursimet totale janë afërsisht 2,550,000 € nga të cilat 2,450,000 € janë për naftë dhe 100,000 € për benzinë duke përdorur prokurimin e centralizuar.**

Për më tepër, ne e dimë që për t'u abonuar për çmimet e karburantit një parapagim prej 13,000 € në vit nga secili AK duhet të paguhet. Ky fakt rrit kursimet e mundshme me afërsisht **3,390,000 € për një periudhë 3-vjeçare.**

[20] https://ask.rks-gov.net/media/3311/i%C3%A7k-ih%C3%A7k-2002-2016-shqip.pdf

## 4.2 Furnizimi me artikuj ushqimorë

### *4.2.1 Furnizimi me mish dhe produkte mishi*

Artikulli i përzgjedhur për analizë është **Mishi i viçit kg** (Viçi i freskët (KOFSHA), 7% yndyrë e lejuar - pa kocka) - Loti 1. Ju lutemi referojuni Aneksit 1 për informacione të detajuara.

**Analiza e opsioneve 1:** Meqenëse projekti ka të bëjë me AQP-në në mënyrë që të përcaktohet nëse këto prokurime ofronin VPP kur krahasohen me proceset konkurruese "normale" të tenderimit, kontrata e përzgjedhur për analizë është kontrata për **artikuj ushqimorë e vitit 2015**, një kontratë e ndarë në 5 Lote, e cila hyri në fuqi në nëntor 2016 dhe skadoi në nëntor 2019.

Kjo kontratë përdoret nga **7 AK** me një vlerë totale përafërsisht **€ 4,500,000.**

Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat shpenzuan sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. OB-të që porositën sasinë më të madhe u përcaktuan nga AQP-ja pasi që nuk ka informacione në Dokumentet e Tenderit për sasinë që vlerësohet ta ketë shpenzuar secili AK.

Sipas mbledhjes së të dhënave nga AQP-ja, 5 OB-të që blenë sasitë më të mëdha janë:

1. Qendra Studentore
2. Qendra Klinike Universitare e Kosovës
3. Shërbimi Korrektues i Kosovës
4. Spitali Rajonal i Gjakovës
5. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2016. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga OB-të përmes emailit. Çmimet e 2 OB-ve, Qendrës Studentore dhe Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nuk u morën parasysh pasi nuk kishin specifikimin e njëjtë dhe prandaj krahasimi i drejtpërdrejtë do të ishte i pakuptimtë.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 233,000 € më shumë krahasuar me çmimin e AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2:** Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) me çmimet kontraktuese të AQP-së për kontratën e nënshkruar në nëntor 2019 e cila skadon në dhjetor 2022.

Kjo kontratë përdoret nga **5 AK** me një vlerë totale përafërsisht **€ 5 500 000 000 (Loti 1, qendror)** (shih kontratën nr. 18 në shtojcën 2).

Për shkak të faktit se kontrata është duke u zbatuar për më shumë se 12 muaj, për të llogaritur kursimet e mundshme, krahasimi është bërë për 12 muaj, d.m.th. **nëntor 2019 - tetor 2020.** Për këtë analizë, një çmim mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK-ja dhe çmimeve të AQP-së përdoren si krahasues.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, kursimet nga prokurimi i centralizuar janë afërsisht 724,000 €.**

### *4.2.2 Furnizim me produkte qumështi*

Artikulli i përzgjedhur për analizë është **Litër qumështi** (Paketimi Tetra pack, yndyrë 3.2%). Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar.

**Analiza e opsioneve 1:** Kontrata e përzgjedhur për analizë është për **artikuj ushqimorë të vitit 2015**, një kontratë e ndarë në 5 Lote, e cila hyri në fuqi në nëntor 2016 dhe skadoi në nëntor 2019.

Kjo kontratë përdoret nga **15 AK** me një vlerë totale përafërsisht **€ 1,760.000 (Loti 2).**

Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. OB-të që shpenzuan sasinë më të madhe u përcaktuan nga AQP-ja pasi që nuk ka informacione në Dokumentet e Tenderit për sasinë që vlerësohet ta ketë blerë secila AK.

Të dhënat e vlerësuara të AQP-së identifikuan 3 OB që siguruan sasitë më të mëdha:

1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
2. Qendra Klinike Universitare e Kosovës
3. Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2016. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga OB-të përmes emailit.

***Rezultatet:* Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 44,100 € më pak krahasuar me çmimin e AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2:** Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) me çmimet kontraktuese të AQP-së për kontratën e nënshkruar në nëntor 2019 e cila skadon në dhjetor 2022.

Kjo kontratë përdoret nga **15 AK** me një vlerë totale përafërsisht**€ 2,050.000 (Loti 1, qendror)** (shih kontratën nr. 20 në Aneksin 2).

Pasi që kjo kontratë është duke u zbatuar për më shumë se 12 muaj, për të vlerësuar kursimet e mundshme, krahasimi është bërë për 12 muaj, d.m.th. **nëntor 2019 - tetor 2020**. Për këtë analizë, një çmim mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK-ja dhe çmimeve të AQP-së përdoren si krahasues.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, kursimet nga prokurimi i centralizuar janë afërsisht 30,600 €.**

### *4.2.3 Furnizimi me ujë, pije të gazuara dhe të pa gazuara*

Artikulli i zgjedhur për analizë është **Uji natyral (0.5 l, ambalazh plastik)**. Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar të të dhënave.

**Analiza e opsioneve 1**: Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur kishte të bënte me **artikuj ushqimorë të vitit 2015**. Kontrata është e ndarë në 5 Lote, të cilat hynë në fuqi në nëntor 2016 dhe skaduan në nëntor 2019

Kjo kontratë përdoret nga **23 AK** me një vlerë totale përafërsisht **€ 945,000 (Loti 3).**

Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. OB-të që shpenzuan sasinë më të madhe u përcaktuan nga AQP-ja pasi që nuk ka informacione në Dokumentet e Tenderit për sasinë që vlerësohet ta ketë blerë secila AK.

Të dhënat e vlerësuar të AQP-së identifikuan 3 OB që blenë sasitë më të mëdha:

1. Policia e Kosovës
2. Zyra e Rregullatorit të Energjisë
3. Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2016. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga OB-të përmes emailit.

***Rezultatet:* Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 3,000 € më shumë krahasuar me çmimin e AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2**: Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) me çmimet kontraktuese të AQP-së për kontratën e nënshkruar në nëntor 2019 e cila skadon në dhjetor 2022.

Kjo kontratë përdoret nga **53 AK** me një vlerë totale përafërsisht**€ 1,650.000 (Loti 3)** (shih kontratën nr. 17 në Aneksin 2).

Pasi që kjo kontratë është duke u zbatuar për më shumë se 12 muaj, për të vlerësuar kursimet e mundshme, krahasimi është bërë për 12 muaj, **d.m.th. nëntor 2019 - tetor 2020**. Për këtë analizë, një çmim mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK-ja dhe çmimeve të AQP-së përdoren si krahasues.

***Rezultatet:* Sipas këtij opsioni, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 16,900.**

### *4.2.4 Furnizimi me artikuj ushqimorë*

Artikulli i përzgjedhur për këtë analizë ishte **Vaji (vaj ushqimor, përbërja: luledielli, i rafinuar, pa kolesterol)**. Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar të të dhënave.

**Analiza e opsioneve 1:** Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur kishte të bënte me **artikuj ushqimorë të vitit 2015**. Kontrata është e ndarë në 5 Lote, e cila hyri në fuqi në nëntor 2016 dhe skadoi në nëntor 2019

Kjo kontratë përdoret nga **18 AK** me një vlerë të përafërt prej **€ 2,394.000 (Loti 4)**.

Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. OB-të që shpenzuan sasinë më të madhe u përcaktuan nga AQP-ja pasi që nuk ka informacione në Dokumentet e Tenderit për sasinë që vlerësohet ta ketë blerë secila AK.

Të dhënat e vlerësuar të AQP-së identifikuan 3 OB që blenë sasitë më të mëdha:

1. Qendra Klinike Universitare e Kosovës
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
3. Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2016. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga OB-të përmes emailit.

***Rezultatet:* Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 51,400 € më shumë krahasuar me çmimin e AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2:** Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) me çmimet kontraktuese të AQP-së për kontratën e nënshkruar në nëntor 2019 e cila skadon në dhjetor 2022.

Kjo kontratë përdoret nga **20 AK** me një vlerë totale përafërsisht**€ 2,796.000 (Loti 4, niveli qendror)** (shih kontratën nr. 21 në Aneksin 2).

Pasi që kjo kontratë është duke u zbatuar për më shumë se 12 muaj, për të vlerësuar kursimet e mundshme, krahasimi është bërë për 12 muaj, d.m.th. **nëntor 2019 - tetor 2020.** Për këtë analizë, një çmim mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK-ja dhe çmimeve të AQP-së përdoren si krahasues.

***Rezultatet:* Sipas këtij opsioni, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 13,900.**

### *4.2.5 Furnizim me bukë dhe brumëra të tjera*

Artikulli i për zgjedhur për analizë ishte **Buka e bardhë (500g)**. Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar të të dhënave.

**Analiza e opsioneve 1:** Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur kishte të bënte me **artikuj ushqimorë të vitit 2015**. Kontrata është e ndarë në 5 Lote, e cila hyri në fuqi në nëntor 2016 dhe skadoi në nëntor 2019

Kjo kontratë përdoret nga **6 KA** me një vlerë totale **prej afërsisht € 3,455.000 (Loti 5)**.

Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. OB-të që shpenzuan sasinë më të madhe u përcaktuan nga AQP-ja pasi që nuk ka informacione në Dokumentet e Tenderit për sasinë që vlerësohet ta ketë blerë secila AK.

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

Të dhënat e vlerësuara të AQP-së identifikuan 3 OB që blenë sasitë më të mëdha:

1. Qendra Studentore
2. Qendra Klinike Universitare e Kosovës
3. Shërbimi Korrektues i Kosovës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2016. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga OB-të përmes emailit.

***Rezultatet:* Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 142,000 € më pak krahasuar me çmimin e AQP-së.**

**Analiza e opsioneve 2**: Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e publikuara nga ASK (çmimet e tregut) me çmimet kontraktuese të AQP-së për kontratën e nënshkruar në nëntor 2019 e cila skadon në dhjetor 2022.

Kjo kontratë përdoret nga **5 AK** me një vlerë totale përafërsisht**€ 1,774.000 (Loti 1, niveli qendror)** (shih kontratën nr. 15 në Aneksin 2).

Pasi që kjo kontratë është duke u zbatuar për më shumë se 12 muaj, për të vlerësuar kursimet e mundshme, krahasimi është bërë për 12 muaj, d.m.th. **nëntor 2019 - tetor 2020**. Për këtë analizë, një çmim mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK-ja dhe çmimeve të AQP-së përdoren si krahasues.

***Rezultatet:* Sipas këtij opsioni, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 345,000.**

## 4.3 Furnizimi me letër dhe artikuj për zyrë

### *4.3.1 Furnizimi me letër A4/80 g/m2*

Artikulli i përzgjedhur për analizë ishte **Letra A4/80 g/m2**. Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar të të dhënave.

**Analiza e opsioneve 1:** Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur ishte për **artikuj për zyrë nga viti 2015**, një kontratë e ndarë në 2 Lote, e cila hyri në fuqi në gusht 2016.

Kjo kontratë përdoret nga **79 AK** me një vlerë prej afërsisht **€ 2,180.000 (Loti 1)**.

AQP-ja kishte analizuar të dhënat e marra nga 31 OB para se ky artikull të përfshihej në prokurimin e centralizuar. Kjo duhej të bëhej pasi AQP-ja nuk përcaktoi sasitë në dokumentet e tenderit. Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar e që ishin përzgjedhur nga analiza e AQP-së.

Të dhënat e vlerësuara të AQP-së identifikuan 3 OB që blenë sasitë më të mëdha:

1. Ministria e Punëve të Brendshme

2. Policia e Kosovës
3. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2015. Çmimet nga OB janë marrë direkt nga analiza e AQP-së.

***Rezultatet:*** **Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 580,000 € më shumë krahasuar me çmimin e AQP-së.**

Analiza e opsioneve 2: Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Meqenëse ASK nuk ofron çmime të tregut për këtë kategori, çmimet e tregut u morën direkt nga OE-të dhe u përcaktua një çmim mesatar. Nga një mostër prej 5 OE të kontaktuar, 3 u përgjigjën.

Çmimi i AQP-së ishte mesatarja e 6 kontratave që AQP-së për 6 Lotet.

***Rezultatet:*** **Sipas këtij opsioni, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 46,000.**

### *4.3.2 Furnizimi me letër A3/80 g/m2*

Artikulli i përzgjedhur për analizë ishte **Letra A3/80 g/m2. Ju** lutemi shikoni Aneksin **1** për analizë të detajuar të të dhënave.

Analiza e opsioneve 1: Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur ishte për **artikuj për zyrë nga viti 2015**, një kontratë e ndarë në 2 Lote, e cila hyri në fuqi në gusht 2016.

Kjo kontratë përdoret nga **79 AK** me një vlerë totale prej afërsisht **€ 2,180.000 (Loti 1)**.

AQP-ja kishte analizuar të dhënat e marra nga 31 OB para se ky artikull të përfshihej në prokurimin e centralizuar. Kjo duhej të bëhej pasi AQP-ja nuk përcaktoi sasitë në dokumentet e tenderit. Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar e që ishin përzgjedhur nga analiza e AQP-së.

Të dhënat e vlerësuara të AQP-së identifikuan 3 OB që siguruan sasitë më të mëdha:

1. Ministria e Punëve të Brendshme
2. Dogana
3. Komuna e Prishtinës

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2015.

***Rezultatet:*** **Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 139,000 € më pak krahasuar me çmimin e AQP-së.**

Analiza e opsioneve 2: Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e

tregut me çmimet e AQP-së të nënshkruara që nga qershori 2020 Meqenëse ASK nuk ofron çmime të tregut për këtë kategori, çmimet e tregut u morën direkt nga OE-të dhe u përcaktua një çmim mesatar. Nga një mostër prej 5 OE të kontaktuar, 3 u përgjigjën.

Çmimi i AQP-së ishte mesatarja e 6 kontratave që AQP-së për 6 Lotet.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 78,000.**

### *4.3.3 Furnizimi me regjistratorë, me ngjyra, me kuti 80 mm gjerësi të përshtatshme për letër A4 me madhësi 475- 75i*

Artikulli i përzgjedhur për analizë ishte regjistratori, me ngjyra, me kuti. Gjerësia 80 mm e përshtatshme për madhësinë e letrës A4 475- 75i Ju lutemi shikoni Aneksin 1 për analizë të detajuar të të dhënave.

Analiza e opsioneve 1: Për këtë analizë, kontrata e përzgjedhur ishte për **artikuj për zyrë nga viti 2015**, një kontratë e ndarë në 2 Lote, e cila hyri në fuqi në gusht 2016.

Kjo kontratë përdoret nga **79 AK** me një vlerë totale prej afërsisht **€ 2,480.000 (Loti 1).**

AQP-ja kishte analizuar të dhënat e marra nga 31 OB para se ky artikull të përfshihej në prokurimin e centralizuar. Kjo duhej të bëhej pasi AQP-ja nuk përcaktoi sasitë në dokumentet e tenderit. Janë marrë 3 çmime të kontratave të mëparshme të OB-ve (para kontratës së AQP-së) të cilat blenë sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar e që ishin përzgjedhur nga analiza e AQP-së.

Të dhënat e vlerësuara të AQP-së identifikuan 3 OB që siguruan sasitë më të mëdha:

1. Ministria e Punëve të Brendshme
2. Policia e Kosovës
3. Ministria e Drejtësisë

Për krahasim, çmimi mesatar i 3 çmimeve të kontratave paraprake të OB-ve është llogaritur dhe krahasuar me çmimin e kontratës së AQP-së për vitin 2015.

***Rezultatet:* Në këtë opsion, OB-të paguanin afërsisht 46,300 € më pak krahasuar me çmimin e AQP-së.**

Analiza e opsioneve 2: Çmimet e marra nga OB-të ishin çmime nga viti 2015, pasi që nga ajo datë AQP-ja ka kontraktuar për këtë kategori në emër të OB-ve. Ky opsion krahason çmimet e tregut me çmimet e AQP-së të nënshkruara që nga qershori 2020 Meqenëse ASK nuk ofron çmime të tregut për këtë kategori, çmimet e tregut u morën direkt nga OE-të dhe u përcaktua një çmim mesatar. Nga një mostër prej 5 OE të kontaktuar, 3 u përgjigjën.

***Rezultatet:* Për këtë opsion, prokurimi i centralizuar ka gjeneruar një kursim prej afërsisht € 70,000.**

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

### 4.4 Kursime të tjera të mundshme

Përmes veprimeve të synuara të prokurimit të centralizuar, arrihen kursime shtesë të mundshme. Për shembull, prokurimi i centralizuar zvogëlon nevojën për proceset e prokurimit në OB-të. Për të vlerësuar kursimet e mundshme të kostos së punës përmes prokurimeve të centralizuara, ne zhvilluam një model duke përdorur numrin standard të ditëve dhe njësitë e kostove të punës dhe e zbatuam këtë për të gjitha OB-të për 10 kategoritë e zgjedhura. Kursimi i mundshëm nga ky modelim ishte **afërsisht 205,000 €**. Detajet e modelit të përdorur janë në Shtojcën 1.

Siç e kemi identifikuar më herët, për blerjen e produkteve të karburantit, OB-të individuale do të duhet të depozitojnë një obligacion (përshkrues në Berëz) prej **13,000 € në vit me furnizuesit e karburantit**. Prokurimi i centralizuar i produkteve të karburantit ka kursyer **3,310.000 € për një periudhë 3-vjeçare.**

## 5. Përmbledhje e analizës

Kjo pjesë ofron një paraqitje përmbledhëse tabelare të kursimeve të mundshme të përgjithshme[21] që janë bërë nën 2 opsionet për secilën kategori të analizuar në raport.

| Artikulli Nr. | Artikulli | Opsioni 1: Krahasimi me Çmimet e OB | Opsioni 2: Krahasimi me Çmimet e Tregut |
|---|---|---|---|
| 1 | Naftë 10 ppm | 380,000 | 2,450.000 |
| 2 | Benzinë 10 ppm | -13,000 | 100,000 |
| 3 | Mish viçi kg (viçi i freskët (KOFSHË), 7% yndyrë e lejuar - pa kocka) | 233,000 | 724,000 |
| 4 | Litër qumështi (ambalazhi Tetra Pack, yndyrë 3.2%) | -44,100 | 30,600 |
| 5 | Ujë natyral (0.5 l, ambalazh plastik) | 3,000 | 16,900 |
| 6 | Vaj (vaj ushqimor, përbërja: luledielli, i rafinuar, pa kolesterol) | 51,400 | 13,900 |
| 7 | Bukë e bardhë (500g). | -142,000 | 345,000 |
| 8 | Letër A4/80 g/m2. | 580,000 | 46,000 |
| 9 | Letër A3/80 g/m2 | -139,000 | 78,000 |
| 10 | Regjistrator | -46,300 | 70,000 |
| | Nën-Total | 863,000 | 3,874.000 |
| | Treguesit tjerë | | |
| 11 | Llogaritja e burimeve njerëzore për 10 artikuj | 205,000 | |

[21] Numrat në tabelë janë të rrumbullakosur.

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

| Artikulli Nr. | Artikulli | Opsioni 1: Krahasimi me Çmimet e OB | Opsioni 2: Krahasimi me Çmimet e Tregut |
|---|---|---|---|
| 12 | Parapagimi në bursë për karburant | 3,390.000 | |
| | GJITHSEJ | **4,458.000** | **3,874.000** |

Sipas Opsionit 1, përbërësi kryesor i 'kursimeve' është parapagimi i karburantit dhe 5 nga 10 artikuj kushtojnë më pak për tu blerë nga OB-të individual sesa përmes prokurimit të centralizuar. Sipas opsionit 2, kursimet kanë gjasë të shkaktojnë lajthitje dhe të jenë të mbivlerësuara pasi që shumë OB nuk i ofrojnë AQP-së llogaritje vjetore të sasive për secilin artikull. Kjo është një kërkesë ligjore por nuk po zbatohet. Si rrjedhojë, meqenëse OB-të nuk ofrojnë të dhëna të tilla, AQP-ja krijon llogaritjet e veta të sasive të OB-ve dhe i shumëzon ato me çmimet e tregut. Në këto raste, AQP-ja në mënyrë arbitrare llogaritë sasitë që janë ndoshta më të larta se sa do të duhej të jenë. Kur këto më pas shumëzohen siç përshkruhet më sipër, rezultati i buxhetit të kostos së vlerësuar është dukshëm më i lartë se vlerat e kontratës për këta artikuj.

Kjo krijon një situatë kur vlera e kontraktuar e AQP-së krahasohet me një vlerësim të gabuar dhe 'kursimet' e AQP-së raportohen në Raportet Vjetore të AQP-së mbi këtë bazë.

## 6. Konstatimet & Rekomandimet

### ➢ Konstatimet

- Edhe me vërejtjet në Seksionin 5 të këtij raporti, ekziston një **probabilitet i lartë i kursimeve nga vëllimet që kontraktohen nga AQP-ja.**
- Shumica e artikujve që blihen në mënyrë qendrore janë për **kontratat e furnizimit.** Historikisht, kjo ishte normë për prokurimin e centralizuar, megjithatë, tani po shfaqen mundësi për kontratat e shërbimit **me blerje qendrore.**
- Pothuajse për të gjitha prokurimet e centralizuara, kriteret kryesore të dhënies së tenderit janë **Çmimi më i ulët** nga një ofertues i përgjegjshëm.
- **Bilancet provuese të auditimit janë përmirësuar** pasi auditorët do të rishikojnë një aktivitet të prokurimit kundrejt aktiviteteve të shumta të prokurimit të iniciuara nga OB.
- Numri i **ankesave në OSHP është zvogëluar** pasi OE-të paraqesin ankesa për një aktivitet të prokurimit në vend që të paraqesin ankesa për të secilën OB-të.
- Ekzistonte një **larmi e çmimeve për artikujt e njëjtë** në kontratat e OB-ve të decentralizuara më parë.
- Çmimet që iu janë ngarkuar OB-ve **nuk pasqyrojnë çmimet e tregut aktual.**
- AQP-ja duhet ta përmirësojë **menaxhimin e kontratave, raportimin dhe zgjidhjen e ankesave.**
- AQP-ja duhet ta përmirësojë **planifikimin e AQP-së, hulumtimin e tregut dhe vlerësimin e vlerës së kontratës.**

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

- Ndërsa AQP-ja **ndan aktivitetet në Lote** për të inkurajuar pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të mesme dhe të vogla, kjo **ndarje nuk është bërë si duhet**.
- **Vlerësimi i tenderëve kërkon më shumë kohë sesa lejohet** me Rregullat dhe Udhëzimet Operacionale për prokurimin publik.

➢ **Rekomandime**

1. Ne kemi vërejtur që për të gjitha aktivitetet AQP-ja përdor kriteret e dhënies së kontratës sipas **Çmimit më të ulët.** AQP-ja duhet të përdorë **kriterin ekonomikisht më të favorshme për dhënien e tenderit** me qëllim të sigurimit të cilësisë gjatë zbatimit të kontratës. Tenderi ekonomikisht më i favorshëm nga AQP-ja do të identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur një qasje të efektivitetit të kostos, siç është kostoja e ciklit jetësor dhe mund të përfshijë proporcionin më të mirë të cilësisë së çmimit, i cili do të vlerësohet në bazë të kritereve, përfshirë aspektet cilësore, mjedisore dhe/ose sociale, të lidhura me çështjen lëndore të kontratës publike.
2. AQP-ja duhet **të trajtojë si duhet çmimet abnormale** pasi që OE-të aplikojnë me çmime jonormalalisht të ulëta dhe rrjedhimisht AK-të përballen me probleme gjatë zbatimit të kontratës. Në mënyrë që të merren çmimet e tregut për 3 artikuj të zgjedhur (Letra A4, letra A3 dhe regjistratorët) për të cilat ASK nuk publikon çmime, projekti iu afrua OE-ve dhe vuri re se çmimet e tregut janë shumë më të larta se ato të kontraktuara nga AQP-ja.
3. AQP-ja duhet të **mbledh sasitë dhe çmimet** nga OB-të para fillimit të një aktiviteti të prokurimit në mënyrë që të analizojë çmimet para nënshkrimit të kontratës për aktivitete të reja.
4. Meqenëse shumë OB nuk japin informacione mbi sasitë dhe vlerësimet e buxhetit kur kërkohet nga AQP-ja, dhe faktin që në këto raste AQP-ja vlerëson në mënyrë arbitrare sasitë që janë ndoshta më të larta se sa do të duhej të jenë, AQP-ja duhet **të mbledh sasitë** për ata artikuj të prokuruar ndër vite nga AQP-ja, nga menaxhmenti i kontratave.
5. AQP-ja duhet **të përcaktojë sasitë e nevojshme për secilin AK** në dokumentet e tenderit në mënyrë që OE-të të dinë se cila BO është shpenzuesi më i madh.
6. AQP-ja duhet **të ketë një ueb faqe të përshtatshme për përdoruesit** në mënyrë që mbledhja e të dhënave dhe kontratat te jenë lehtësisht të çastshme dhe në dispozicion të OB-ve.
7. AQP-ja duhet **të kryejë një analizë më gjithëpërfshirëse** të propozimeve të AK-së dhe të merr në konsideratë situatën aktuale të tregut, kushtet e konkurrencës, larminë e ofertave dhe dinamikën e kohës para se AQP-ja të finalizojë kërkesën për listën e prokurimeve qendrore.
8. AQP-ja duhet të **organizojë punëtori** me OB-të për të adresuar të gjitha çështjet e ngritura nga OB-të gjatë zbatimit të kontratës.
9. AQP-ja duhet të **monitorojë zbatimin e kontratave** dhe të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të eliminuar kontestet gjatë zbatimit të kontratës ndërmjet OB-ve dhe OE-ve.
10. AQP-ja duhet të **mbledh të dhëna për zbatimin e kontratës** në bazë tre mujore dhe do **t'i publikojë ato** në mënyrë që OB-të dhe palët e tjera të interesuara të jenë në dijeni për sasitë e blera.

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

11. AQP-ja duhet të **zgjerojë listën e artikujve të përdorimit të zakonshëm**, të përfshijë **kontratat e shërbimeve në fusha të tilla si shërbimet e sigurisë, shërbimet e pastrimit, shërbimet e deratizimit, dezinektimit, dezinfektimit "DDD"** pasi këto aktivitete janë të përbashkëta për të gjitha OB-të.
12. Ndërsa çmimi është një kriter i rëndësishëm në dhënien e kontratës, **kritere të tjera** të tilla si ndikimi në mjedis, ndikimi social dhe qëndrueshmëria duhet të merren parasysh nga AQP-ja.
13. AQP-ja duhet të **vlerësojë tenderët në përputhje me kërkesat kohore** në bazë të Rregullave dhe Udhëzimeve Operacionale për Prokurimin Publik.
14. AQP-ja dhe Ministria e Financave duhet të sigurojnë që të gjitha OB-të, siç kërkohet me ligj, **të ofrojnë informacione vjetore** mbi sasitë e artikujve të blerë në mënyrë qendrore dhe ndarjen buxhetore për këta artikuj.

## Referenca

1. Ligji për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042
2. Raporti Vjetor i KRPP-së 2019
3. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2015 - Furnizimi me Karburant - një Lot, niveli Qendror
4. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2017 - Furnizimi me Karburant - gjashtë Lote, Niveli Lokal
5. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2018 - Furnizimi me Karburant - pesë Lote, Niveli Qendror
6. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2019 - Furnizimi me Karburant - gjashtë Lote, Niveli Lokal
7. Çmimet e përcaktuara të AQP-së për Karburant dhe Benzinë, të publikuara në ueb faqen e AQP-së
8. Agjencia e Statistikave të Kosovës publikoi çmimet e karburantit
9. Raporti i Analizave të Karburantit të AQP-së
10. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2015 - Artikuj ushqimor – 5 lote, niveli Qendror
11. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2018 - Artikuj ushqimorë - 5 kategori, 2 lote për kategori, Niveli qendror dhe lokal
12. Çmimet e artikujve ushqimor të shpenzuesve më të mëdhenjtë të AK-së për 5 artikuj të zgjedhur
13. Çmimet e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për artikuj ushqimor për 5 artikujt e përzgjedhur
14. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2015 Furnizimi me letër dhe material zyrtar - 2 Lote, Niveli Qendror
15. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2017, Furnizimi me letër - 6 Lote, Niveli Lokal
16. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2017, Furnizimi me material zyrtar - 7 Lote, Niveli Lokal
17. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2018, Furnizimi me material zyrtar - 7 Lote, Niveli Qendror
18. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2019, Furnizimi me letër - 6 Lote, Niveli Lokal
19. Dokumentet e Tenderit të AQP-së 2019, Furnizimi me material zyrtar - 7 Lote, Niveli Qendror
20. Çmimet e tregut të OE-ve prej muajit dhjetor 2020
21. Raporti i AQP-së për Analizimin e artikujve për Letër dhe material zyrtar
22. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2015, Niveli Qendror
23. Kontrata e AQP-së për Furnizim me material zyrtar për vitin 2015, Niveli Qendror
24. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2020 –Loti 1, Niveli lokal
25. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2000 - Loti 2, Niveli lokal

26. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2000 - Loti 3, Niveli lokal
27. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2000 - Loti 4, Niveli lokal
28. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2000 - Loti 5, Niveli lokal
29. Kontrata e AQP-së për Furnizim me letër e vitit 2000 - Loti 6, Niveli lokal
30. Kontrata e AQP-së për Furnizim me material zyrtar për vitin 2019, Niveli Qendror

## Aneksi 1: Informacione dhe të dhëna të detajuara që mbështesin përmbajtjen e raportit

➢ ***Kategoritë/Artikujt e Prokurimit***

Në total AQP-ja, siç autorizohet nga Qeveria, bënë prokurimin e 18 **kategorive të artikujve si në vijim:**

| Nr. | 2015 | 2016 | 2017 |
|---|---|---|---|
| 1 | Furnizimi me karburant | | |
| 2 | Furnizimi me material zyrtar | | |
| 3 | Shërbime transporti (furnizim me bileta) | | |
| 4 | Furnizimi me vaj të rëndë (mazut) | | |
| 5 | Furnizimi me pelet | | |
| 6 | Furnizimi me goma | | |
| 7 | Furnizimi me dru dhe qymyr (2 lote) | | |
| 8 | Furnizimi me material higjienik (2 lote) | | |
| 9 | Furnizimi me artikuj ushqimorë (5 lote) | | |
| 10 | Shërbime pastrimi (11 lote) | | |
| 11 | Furnizimi me pemë dhe perime (FA me disa OE) | | |
| 12 | | Marrja me qira e makinave fotokopjuese | |
| 13 | | Pajisje të TI-së | |
| 14 | | Furnizimi me lubrifikantë | |
| 15 | | | Furnizimi me automjete |
| 16 | | | Marrja me qira e automjeteve |
| 17 | | | Furnizime me mobilie |
| 18 | | | Shërbime për printim |

Kjo analizë shqyrtoi 3 **aktivitete të prokurimit qendror** të AQP-së gjatë dy viteve të fundit.

➢ ***Formula e Analizës së Opsioneve***

Për artikujt e përzgjedhur, analiza krahasuese u bazua në dy opsione:

1. **Analiza e opsioneve 1:** Janë marrë 3 çmime për artikull nga OB-ve (modeli i funksionimit të decentralizuar) të cilat shpenzuan sasinë më të madhe në kontratën e centralizuar. Një çmim mesatar është përzgjedhur dhe krahasuar me çmimet e AQP-së.

| Artikulli | Formula |
|---|---|

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

| | |
|---|---|
| Naftë & Benzinë | • Çmimi sipas ASK 2012 * Sasia e Naftës në litra e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të ASK<br>• Çmimi mesatar i OB-ve Shtator 2012 * Sasia e Naftës e parashikuar për 3 vite = Vlera sipas çmimit të OB-ve<br>**Vlera sipas çmimit të ASK-së - Vlera sipas çmimit të OB-ve = Kursimet** |
| Artikujt ushqimorë (mish, qumësht, ujë, vaj dhe bukë) | • Çmimi mesatar i çmimeve të OB-ve * Sasia sipas TD = Vlera sipas çmimit të OB-ve<br>• Çmimi i AQP-së * Sasia sipas TD = Vlera sipas çmimit të AQP-së<br>**Vlera sipas çmimit të OB - Vlera sipas çmimit të AQP-së = Kursimet** |
| Letër A4 & A3 & Regjistrator | • Çmimi mesatar i çmimeve të OB-ve * Sasia sipas TD = Vlera sipas çmimit të OB-ve<br>• Çmimi i AQP-së * Sasia sipas TD = Vlera sipas çmimit të AQP-së<br>**Vlera sipas çmimit të OB - Vlera sipas çmimit të AQP-së = Kursimet** |

2. **Analiza e opsioneve 2:** Meqenëse çmimet e mbledhura nga OB-të ishin çmime që nga viti bazë 2015, koha kur AQP-ja filloi kontraktimin në emër të OB-ve, raporti është azhurnuar - për 7 artikujt e parë të renditur në mostër - me çmimet e publikuara nga ASK dhe këto u krahasuan me çmimet e AQP-së.

| Artikulli | Formula |
|---|---|
| Naftë & Benzinë | • 15 çmimet e publikuara të AQP-së * Sasia e Naftës në litra e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të AQP-së<br>• Çmimi mesatar i 15 çmimeve të publikuara nga ASK * Sasia e Naftës e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të tregut<br>**Vlera sipas çmimit të AQP-së - Vlera sipas çmimit të ASK-së = Kursimet** |
| Artikujt ushqimorë (mish, qumësht, ujë, vaj dhe bukë) | • Çmimi AQP-së * Sasia e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të AQP-së<br>• Çmimi mesatar i 12 çmimeve të publikuara nga ASK * Sasia e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të tregut<br>**Vlera sipas çmimit të AQP-së - Vlera sipas çmimit të ASK-së = Kursimet** |
| Letër A4 & A3 & Regjistrator | • Çmimi AQP-së * Sasia e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të AQP-së<br>• Çmimi mesatar i OE-ve * Sasia e paraparë për 3 vite = Vlera sipas çmimit të tregut |

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

| | |
|---|---|
| | **Vlera sipas çmimit të AQP-së - Vlera sipas çmimit të OE-ve = Kursimet** |

➢ ***Analiza e opsionit të artikujve të zgjedhur***

**1. Produktet e benzinës (Naftë 10ppm dhe Benzinë 10ppm)**

*Historiku*

Pas miratimit të listës së prokurimeve të centralizuara nga qeveria, përmes një UA për prokurimet e centralizuara, nënshkruar nga Kryeministri me 25.02.2015, filluan prokurimet e para të centralizuara dhe i pari në listë ishte "**Furnizimi me karburant**"

Që nga viti 2015, AQP ka kryer 4 aktivitete të prokurimit për furnizimin me karburant:

1. 10.05.2015 - Niveli qendror (80 AK) - vetëm 1 lot; kontrata e nënshkruar në shkurt 2016 ***(nëntë muaj[22])***
2. 05.05.2017 - Niveli lokal (69 AK) - aktiviteti i ndarë në 6 lote; kontratat e nënshkruara në shkurt 2018 ***(nëntë muaj)***
3. 12.08.2018 - Niveli qendror (87 AK) - aktiviteti i ndarë në 5 lote; kontratat e nënshkruara në maj 2019 ***(nëntë muaj)***
4. 30.12.2019 - Niveli lokal (69 AK) - aktiviteti i ndarë në 6 lote; kontratat e nënshkruara në maj 2020 ***(pesë muaj)***

Para fillimit të aktivitetit të parë të centralizuar të prokurimit për "Furnizim me karburante" në vitin 2015, AQP kishte filluar me mbledhjen e të dhënave. Një pyetësor ishte përgatitur nga AQP-ja, i cili iu dërgua AK-ve dhe u publikua në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) për të mbledhur të dhëna nga AK-të. Këto të dhëna u përdorën për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përcaktimin e sasive për prokurimin e karburantit.

Pyetësori kërkoi përgjigje lidhur me:

- Atë se kur është nënshkruar kontrata dhe kur skadon ajo;
- Sasia e parashikuar, sasia e porositur vitin paraprak;
- Numri i tenderëve të pranuar, numri i tenderëve të përgjegjshëm të pranuar;
- Atë se sa herë i njëjti aktivitet u rishpall (ri-tenderim).
- Nëse AK ishte përshkrues (abonues) në Plats Price; dhe
- Çmimi për litër që AK pagoi.

AQP-ja, gjatë mbledhjes së të dhënave, hasi në një larmi çmimesh për të njëjtin artikull në kontrata të ndryshme të nënshkruara dhe zbatuara nga AK-të. Është vërejtur gjithashtu se përgatitja e specifikimeve teknike nuk ishte në përputhje me kërkesat ligjore. Në shumicën e rasteve, specifikimet teknike, në këto kontrata, u përgjithësuan pa ndonjë përshkrim të hollësishëm të llojit ose karakteristikave teknike.

[22] Kohëzgjatja nga fillimi deri në nënshkrimin e kontratës.

Krijimi i çmimeve për furnizimin me karburante nuk ishte një çmim fiks, por çmimet i nënshtroheshin rregullimeve (ndryshimeve). Çmimi ishte bërë nga:

1. **Komponentët e çmimeve fikse** të tilla si
   - ✓ primi i furnizuesit (marzha e kontraktuesit si kriteri i vetëm i vlerësimit),
   - ✓ primi i rafinerisë,
   - ✓ tarifat e pagueshme për shërbimet doganore,
   - ✓ tarifat e pagueshme për transportin, TVSH-në, dhe
2. **Komponentët e çmimeve variabile** të tilla si
   - ✓ çmimi mesatar mujor Platts (baza mesdhetare CIF),
   - ✓ kursi mesatar i këmbimit (USD/Euro) nga Banka Qendrore Evropiane.

AQP-ja, gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, ka marrë parasysh rekomandimet e BB:

| Rekomandimi i BB | Zbatimi i AQP-së |
|---|---|
| Krijimi i një procesi zyrtar për të përcaktuar referencën e çmimit (bazat) | |
| Përdorimi i një metode të qartë dhe unitare për tenderimin e karburanteve dhe vlerësimin e çmimeve | Formula për përcaktimin e çmimit është pjesë e dokumenteve të tenderit |
| Mbajtja e komponentëve të ndryshueshëm të çmimeve për shkak të ndryshimeve në tregun botëror | Çmimet e ndryshueshme |
| Shqyrtimi i centralizimit të mundshëm të prokurimit të karburantit nga AQP-ja | Fillimi i procedurës së parë në vitin 2015 |
| Dhënia e kontratës kornizë për më shumë se një furnizues, duke marrë parasysh shpërndarjen rajonale | Aktiviteti i ndarë në lote |
| Kontrata kornizë duhet të jepet me kohëzgjatje prej dy viteve | Kontrata të jepet për tre vite |

*Furnizim me naftë (Naftë 10 ppm dhe Benzinë 10 ppm)*

Meqenëse projekti duhet të bëjë analizat e përfitimit të kostos për kontratat e realizuara dy vitet e fundit, kontrata e përzgjedhur për analizë është kontrata për **Furnizim me karburant - Niveli qendror**, një kontratë e ndarë në 5 Lote e cila hyri në fuqi me 12.07.2019 dhe skadon me 11.07.2022 (shih kontratat Nr. 8-12 në Aneksin 2).

Kjo kontratë përdoret nga 87 AK ku planifikohet të shpenzohen gjithsej **29,169,800 litra naftë dhe 1,018,700 litra benzinë.**

**Siç është përmendur në pjesën e Metodologjisë, për të bërë një analizë të hollësishme përdoren 2 mundësi krahasimi.**

*Aktiviteti 4.3: Aktivitetet e prokurimit të centralizuar do të ofrojnë dëshmi të qarta se ata artikuj që blihen përmes prokurimit të centralizuar sigurojnë vlerën për para kur krahasohen me veprimet konkurruese të tenderimit.*

## Analiza e opsioneve 1:

Janë marrë (3) çmime nga OB-të të cilat kishin shpenzuar sasinë më të madhe sipas kontratës së centralizuar . OB-të të cilat shpenzuan sasinë më të madhe u identifikuan nga Dokumentet e Tenderit.

3 OB-të të cilat shpenzuan sasinë më të madhe sipas kontratës për Naftë janë:

1. Policia e Kosovës - naftë
2. Ministria e Drejtësisë - naftë
3. Ministria e Forcës së Sigurisë - naftë

3 OB-të të cilat shpenzuan sasinë më të madhe sipas kontratës për Benzinë janë:

1. Ministria e Infrastrukturës - benzinë
2. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - benzinë
3. Ministria e Shëndetësisë - benzinë

Për krahasim, çmimet e shpenzuesve më të mëdhenj të OB-ve u morën parasysh dhe u krahasuan me çmimet e publikuara nga ASK-ja për vitin 2012[23]. Çmimet e shpenzuesve më të mëdhenj të OB-ve bazohen në një analizë të bërë nga AQP-ja në vitin 2012.

| Naftë | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Nr.* | *AK* | *Sasia e Naftës (në litra e parashikuar për 3 vite)* | *Çmimi i ASK-së (2012)* | *Vlera sipas çmimit të ASK-së* | *Çmimi i OB-së (shtator 2012)* | *Vlera sipas çmimit të OB-së* | *Dallimi* |
| 1 | Policia e Kosovës | 9,705,000.00 | 1.32 | 12,810,600.00 | 1.3692 | 13,288,086.00 | 477,486.00 |
| 2 | Ministria e Drejtësisë | 3,448,900.00 | 1.32 | 4,552,548.00 | 1.3097 | 4,517,024.33 | -35,523.67 |
| 3 | Ministria e Forcës së Sigurisë | 4,750,000.00 | 1.32 | 6,270,000.00 | 1.345 | 6,388,750.00 | 118,750.00 |
| | **Gjithsej** | **17,903,900.00** | | **23,633,148.00** | | **24,193,860.33** | **560,712.33** |

**Kjo tregon që këto OB kanë paguar 560,712.33 € më shumë se çmimi i tregut.**

| Benzinë | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Nr.* | *AK* | *Sasia e Benzinës (në litra e* | *Çmimi i ASK-së (2012)* | *Vlera sipas çmimit të ASK-së* | *Çmimi i OB-së* | *Vlera sipas çmimit të OB-së* | *Dallimi* |

[23] https://esk.rks-gov.net/media/3311/i%C3%A7k-ii%C3%A7k-2002-2016-shqip.pdf

| | | *parashikuar për 3 vite)* | | | *(shtator 2012)* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Ministria e Infrastrukturës | 186,000.00 | 1.33 | 247,380.00 | 1.3053 | 242,785.80 | -4,594.20 |
| 2 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 180,000.00 | 1.33 | 239,400.00 | 1.3443 | 241,974.00 | 2,574.00 |
| 3 | Ministria e Shëndetësisë | 60,000.00 | 1.33 | 79,800.00 | 1.249 | 74,940.00 | -4,860.00 |
| | **Gjithsej** | **426,000.00** | | **566,580.00** | | **559,699.80** | **6,880,220** |

**Kjo tregon që këto OB kanë paguar 6,880.20 € më pak se çmimi i tregut.**

Nëse përcaktohet një çmim mesatar nga 3 shpenzuesit më të mëdhenj të OB-ve dhe krahasohet me çmimet e ASK-së, rezultatet e mëposhtme janë:

| **Naftë** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Nr.* | *AK* | *Sasia e Naftës (në litra e parashikuar për 3 vite)* | *Çmimi i ASK-së (2012)* | *Vlera sipas çmimit të ASK-së* | *Çmimi i OB-së (shtator 2012)* | *Vlera sipas çmimit të OB-së* | *Dallimi* |
| 1 | Policia e Kosovës | 9,705,000.00 | 1.32 | 12,810,600.00 | 1.3413 | 13,017,316.50 | 206,716.50 |
| 2 | Ministria e Drejtësisë | 3,448,900.00 | 1.32 | 4,552,548.00 | 1.3413 | 4,626,009.57 | 73,461.57 |
| 3 | Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës | 4,750,000.00 | 1.32 | 6,270,000.00 | 1.3413 | 6,371,175.00 | 101,175.00 |
| | **Gjithsej** | **17,903,900.00** | | **23,633,148.00** | | **24,014,501.07** | **381,353.07** |

**Kjo tregon që këto OB kanë paguar 381,353.07 € më shumë se çmimi i tregut.**

| **Benzinë** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Nr.* | *AK* | *Sasia e Benzinës (në litra e parashikuar për 3 vite)* | *Çmimi i ASK-së (2012)* | *Vlera sipas çmimit të ASK-së* | *Çmimi i OB-së (shtator 2012)* | *Vlera sipas çmimit të OB-së* | *Dallimi* |
| 1 | Ministria e Infrastrukturës | 186,000.00 | 1.33 | 247,380.00 | 1.2995 | 241,707.00 | -5,673.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale | 180,000.00 | 1.33 | 239,400.00 | 1.2995 | 233,910.00 | -5,490.00 |
| 3 | Ministria e Shëndetësisë | 60,000.00 | 1.33 | 79,800.00 | 1.2995 | 77,970.00 | -1,830.00 |
| | **Gjithsej** | **426,000.00** | | **566,580.00** | | **553,587.00** | **-12,993.00** |

**Kjo tregon që këto OB kanë paguar 12,993.00 € më pak se çmimi i tregut.**

## Analiza e opsioneve 2:

Në lidhje me faktin se çmimet e mbledhura nga OB-të ishin çmime nga viti 2012 - pasi që nga viti 2015 AQP-ja ka vazhduar lidhjen e kontratave për këtë kategori në emër të OB-ve - opsioni i dytë i raportit krahason çmimet e publikuara nga ASK-ja (çmimet e tregut) me Çmimet e AQP-së.

Çmimi i marrë parasysh ishte çmimi i tregut (ASK) i **muajit gusht 2019** pasi kontrata ishte nënshkruar në **gusht 2019**

| Artikulli | Muaji/Viti | Çmimi i publikuar nga ASK | Çmimi i AQP-së për Lotin 1 dhe 2 | Çmimi i AQP-së për Lotin 3, 4 dhe 5 |
|---|---|---|---|---|
| **Naftë** | Gusht 2019 | 1.15[24] | 1.0399[25] | 1.0374[26] |
| **Benzinë** | Gusht 2019 | 1.16[27] | 1.0157[28] | 1.0132[29] |

**NAFTË 10ppm**

| **Kontrata e nënshkruar në gusht 2019** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| *Loti* | *Nr. i AK-ve* | *Sasia e Naftës (në litra e parashikuar për 3 vite)* | *Çmimi i kontratës së AQP-së (gusht 2019)* | *Vlera sipas çmimit të AQP-së* | *Çmimi i ASK-së ( gusht 2019)* | *Vlera sipas çmimit të tregut të ASK-së* | *Dallimi* |
| 1 | 1 | 9,705,000.00 | 1.0399 | 10,092,229.50 | 1.15 | 11,160,750.00 | 1,068,520.50 |
| 2 | 32 | 5,843,400.00 | 1.0399 | 6,076,551.66 | 1.15 | 6,719,910.00 | 643,358.34 |
| 3 | 25 | 4,567,100.00 | 1.0374 | 4,737,909.54 | 1.15 | 5,252,165.00 | 514,255.46 |
| 4 | 26 | 2,141,300.00 | 1.0374 | 2,221,384.62 | 1.15 | 2,462,495.00 | 241,110.38 |

[24] https://ask.rks-gov.net/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit-lh%C3%A7k-gusht-2019/
[25] https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/Vendim-per-formimin-e-cmimit-te-karbura-nteve-GUSHT-2019-HIB-PETROL-LOT-12.pdf
[26] https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/Vendim-per-formimin-e-cmimeve-te-Karburant-it-GUSHT-2019-Petrol-Company-Lot-345.pdf
[27] https://ask.rks-gov.net/add-news/indeksi-i-harmonizuar-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit-lh%C3%A7k-gusht-2019/
[28] https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/Vendim-per-formimin-e-cmimit-te-karbura-nteve-GUSHT-2019-HIB-PETROL-LOT-12.pdf
[29] https://aqp.rks-gov.net/wp-content/uploads/2019/09/Vendim-per-formimin-e-cmimeve-te-Karburant-it-GUSHT-2019-Petrol-Company-Lot-345.pdf

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | 3 | 6,913,000.00 | 1.0374 | 7,171,546.20 | 1.15 | 7,949,950.00 | 778,403.80 |
| **Gjithsej** | | **29,169,800.00** | | **30,299,621.52** | | **33,545,270.00** | **3,245,648.48** |

**BENZINË 10ppm**

| **Kontrata e nënshkruar në gusht 2019** | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
